



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr-28/2008, dispozitave të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Nr-03/L-049, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr-27/2008, nenit, 28, paragrafi 2, pika (b), 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, te Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën,-----miraton këtë:

### Projektet - V E N D I M

Për ri-alokimin e mjeteve nga fondi burimor (38), Granti Qeveritar-Rezervat për vitin fiskal 2025 në projektin kapital.

#### Neni 1

1.1 Në bazë të Ligjit të Buxhetit Nr.08/L-332 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2025 nga Rezervat e projektit kapitale që duhet të buxhetohen në projektin kapital është shuma prej 200,000.00.00€ (180,000.00+20,000.00), e që në total i bie shuma prej = **200,000.00€** si rezervë, e cila duhet të kalojë në kategorinë aktive të projekteve kapitale.

1.2 Shuma e lartshënuar do të transferohet-alokohet në këtë projekt kapitale që nuk i ka plotësuar kriteret sipas UA-Nr. 04/2019 dhe UA-Nr .06/2019 për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale e që tani konsiderojmë se janë plotësuar kërkesat e Udhëzimeve Administrative në fjalë.

#### Neni 2

**Lista e projekteve kapitale që kalojnë nga Rezervat në projekte kapitale për vitin fiskal 2025.**

Programi	Kodi i Programit	Kodi i Projektit	Emërtimi i Projektit	10-BKK 2025	21-THV 2025	Totali 2025
624180-Shërbimet Publike, Mbrojtje Civile, Emergjencia						
180120-Infrastruktura Rrugore-Suhareke						
180	18012	Projekt i RI	Blerja e auto fshesës për pastrimin e rrugëve dhe trotuareve, traktor me pajisje përcjellëse për Eko-Theranda	180,000.00	20,000.00	200,000.00
Totali -Shërbimet Publike, Mbrojtje Civile, Emergjencia				180,000.00	20,000.00	200,000.00
T TOTALI KOMUNAL :				180,000.00	20,000.00	200,000.00

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

#### Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024” dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

### KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-\_\_\_\_\_  
Me datë\_\_\_\_\_

Kryesuesi i Kuvendit  
\_\_\_\_\_  
Mr.ec Bexhet KUÇI